




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATË/A:	01/10/2015
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP – 03-03/2856/15
PËR/ZA/TO:	z. Haxhi BEJTA Menaxher i Prokurimit - Komuna Skenderaj
CC:	z. Fadil NURA Nënkryetar – Komuna Skenderaj
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin: “Asfaltimi i rrugëve në qytet me segmente – Rruga: Kuvendi i Kaçanikut, Rruga: Nënë Tereza; Rruga: Beqir Hajrizi; Rruga: Motrat Qiriazi me gjatësi 2,600 m”

I nderuar z. BEJTA,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin: “Asfaltimi i rrugëve në qytet me segmente – Rruga: Kuvendi i Kaçanikut, Rruga: Nënë Tereza; Rruga: Beqir Hajrizi; Rruga: Motrat Qiriazi me gjatësi 2,600 m” me numër prokurimi: 643/15/042/521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me Tenderin Publik: “Asfaltimi i rrugëve në qytet me segmente – Rruga: Kuvendi i Kaçanikut, Rruga: Nënë Tereza; Rruga: Beqir Hajrizi; Rruga: Motrat Qiriazi me gjatësi 2,600 m” me numër prokurimi: 643/15/042/521, në mënyrë që të procedohet në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Skenderajt, bazuar në nevojën për ndërtimin e segmenteve rrugore në qytetin e Skenderajt, ka paraparë aktivitetet prokurimi me Procedurë të Hapur. Aktiviteti i prokurimit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik është shpallur më datë: 18/09/2015.

Agjencia kundër Korrupsion ka identifikuar se komuna e Skenderajt gjatë përpilimit të dosjes së tenderit të lartë cekur nuk ka dhënë vëmendjen e duhur, ku edhe janë bërë disa shkelje që bien ndesh me legjislacionin për Prokurim Publik.

Në Dosjen e Tenderit Asfaltimi i rrugëve në qytet me segmente – Rruga: Kuvendi i Kaçanikut, Rruga: Nënë Tereza; Rruga: Beqir Hajrizi; Rruga: Motrat Qiriazhi me gjatësi 2,600 m”, në SEKSIONI II, FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT, tek pika 9.1 Kapaciteti teknik dhe profesional, nën-pika 8, kërkohet që: *“Një referencë ose dokument që dëshmon se OE e ka të realizuar së paku një projekt të natyrës së njëjtë në vlerë të madhe prej 500,000,00 € në tre vitet e fundit”*. Si dhe tek Dëshmia e kërkuar Dokumentare kërkohet: *“Se operatori ekonomikë ka realizuar se paku një projekt në vlerë prej 500,000,00 € në tri(3) vitet e fundit.”* Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë që Operatori Ekonomik të ketë realizuar punët e natyrës së ngjashme me natyrën e punës që zhvillohet aktiviteti i prokurimit, edhe atë mund ta kërkojë për periudhën e tre viteve të fundit duke i vendosur edhe një vlerë të caktuar të projekteve, por në asnjë mënyrë të caktohet vlera e caktuar për një projekt me vlerë konkrete. Në këtë rast që është kërkuar së paku se paku një projekt në vlerë prej 500,000,00 €, Agjencia konsideron se ky është kriter diskriminues dhe si i tillë nuk i lë hapësirë konkurrencës së lirë të tregut.

Autoriteti Kontraktues gjithashtu tek “Para masa dhe Para llogaria” nuk ka specifikuar në detaje emërtimet e rrugëve sipas Dosjes së Tenderit të këtij projekti. Pra, Autoriteti Kontraktues është i detyruar që para fillimit të aktivitetit të prokurimit, të përgatitë specifikimet teknike, termat e referencës, dhe parametrat e punës në përputhje me vëllimin e punës e cila duhet të realizohet, duke përfshirë edhe vend ndodhjen e saktë të realizimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, si dhe Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042; Pikën 9 Funkcionet e Njesisë së Kërkesës dhe Pikën 23, Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Agjencia Kundër Korrupsion i rekomandon Autoritetit Kontraktues anulimin e këtij aktiviteti të prokurimi. Në rast të Ri Tenderimit, të përpilohet dosja në mënyrë më të përshtatshme duke u bazuar në rekomandimet që dalin nga ky Opinion.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !